FAKULTETI I EKONOMISË, QEVERISJES DHE DREJTËSISË

DEPARTAMENTI I EKONOMISË, SIPËRMARRJES DHE FINANCËS
DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

THIRRJE PËR APLIKIME NË PROGRAMIN E DOKTORATURËS NË "SHKENCA EKONOMIKE DHE JURIDIKE' PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, PRANË UNIVERSITETIT "BARLETI"

Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë shpall hapjen e aplikimeve për pranimin në Programin e Doktoraturës në "Shkenca Ekonomike dhe Juridike", për vitin akademik 2026–2027, pranë Universitetit "Barleti", në fushat dhe nënfushat e mëposhtme të studimit:

1. **Shkenca Ekonomike:**

- Kontabilitet
- Financë
- Menaxhim, Sipërmarrje dhe Novacion
- Marketing dhe Sjellje Konsumatore

2. **Shkenca Juridike:**

- Studime Kushtetuese
- E Drejtë Ndërkombëtare Publike
- E Drejtë Evropiane
- E Drejta Tregtare në Bashkimin Evropian
- E Drejtë Penale dhe Procedurë Penale
- Ligji Penal dhe Parimet e Zbatimit të tij
- Kriminologji & Penologji
- Krimi Ekonomiko-Financiar

Hapja e aplikimeve për programin e Doktoraturës në "Shkenca Ekonomike dhe Juridike" për vitin akademik 2026 - 2027 mbështetet në aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

1. Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë";
2. VKM nr. 418, datë 10.05.2017, "Për standardet, kriteret, procedurat e krijimit, riorganizimit, ndarjes, shkrirjes ose mbylljes së institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre";
3. VKM nr. 112, datë 23.02.2018, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe standardet për marrjen e titujve akademikë 'Profesor i Asociuar' dhe 'Profesor'", e ndryshuar me VKM nr. 808, datë 11.12.2019;
4. VKM nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e një programi studimi të ofruar nga IAL";
5. VKM nr. 824, datë 24.12.2021, "Për Kodin e Cilësisë";
6. VKM nr. 777, datë 26.12.2018, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor'", e ndryshuar me VKM nr. 99, datë 05.02.2020;
7. Udhëzimin nr. 29, datë 18.12.2019, "Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë";
8. Udhëzimin nr. 29, datë 18.12.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL";
9. Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, të Ministrit të Arsimit, "Për licencimin, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve dhe programeve të studimit", i ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 31.03.2021, i ndryshuar;
10. Udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, të Ministrit të Arsimit, "Për përcaktimin e niveleve të gjuhës së huaj", i ndryshuar;
11. Statutin e universitetit "Barleti";
12. Rregulloren "Për programet e studimit të doktoraturës në universitetin 'Barleti'";
13. Urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 406, datë 01.08.2024, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, doktoratë në "Shkenca ekonomike dhe juridike" në universitetin "Barleti".

KRITERET E PRANIMIT DHE TË APLIKIMIT NË PROGRAMIN E DOKTORATURËS NË "SHKENCA EKONOMIKE DHE JURIDIKE" PËR VITIN AKADEMIK 2026 - 2027, PRANË UNIVERSITETIT "BARLETI"

Çdo person që përmbush kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 78, dhe neni 79, si dhe Rregullores së studimeve të doktoratës të Univeristetit Barleti, mund të APLIKOJË për t'u pranuar në ciklin e tretë të studimeve, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

1. Të ketë përfunduar dhe të zotërojë diplomë të studimeve të larta universitare në Ekonomi dhe Drejtësi;

2. Të zotërojë një diplomë "Bachelor", "Master i Shkencave" ose një kualifikim ekuivalent në të njëjtën disiplinë ose të ngjashme, nga një program i akredituar, me notë mesatare secila jo më pak se 8 (tetë) ose ekuivalente me të;

3. Diplomat e fituara sipas pikës (1) dhe (2) në një Institucion të Arsimit të Lartë jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jenë të ekuivalentuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin.

4. Të ketë njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja, si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të paktën në nivelin B2, të vërtetuar përmes certifikimeve dhe rezultateve të testimeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve, brenda afateve të vlefshmërisë së certifikimeve të lëshuara në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 4, i ndryshuar, të Ministrisë së Arsimit. Aplikantët që kanë fituar një diplomë pas përfundimit të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e mësipërme, të njësuar nga ministria përkatëse, shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës;

5. Të ketë angazhime si bashkëpunëtor i brendshëm/ i jashtëm në një Institucion të Arsimit të Lartë, institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, ose forma të tjera të angazhimit në kërkime;

6. Të mos jetë i dënuar penalisht;

7. Të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij, apo të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, së të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave të plagjaturës.

KRITERE SPECIFIKE

Kandidatët që aplikojnë në fushën e Shkencave Juridike, pranë Departamentit të Drejtësisë të Universitetit "Barleti", duhet të plotësojnë, përveç kritereve të përgjithshme të pranimit, edhe kriterin specifik të mëposhtëm:

- Të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve në programin "Master i Shkencave", në një nga nënfushat e së Drejtës, si: E Drejtë Penale, E Drejtë Tregtare, E Drejtë Civile, E Drejtë Publike, E Drejtë Kushtetuese, E Drejtë e Bashkimit Evropian, apo fusha të tjera të përafërta të studimit juridik.

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesa e studentit kandidat për të ndjekur studimet në programin e doktoraturës, në të cilën përfshihet edhe nënfusha e kërkimit ku kandidati ka interes;
2. Curriculum Vitae (CV);
3. Fotokopje e kartës së identitetit;
4. Fotokopje e noterizuar e diplomave të dy niveleve shoqëruar me suplementet përkatëse;
5. Dëshmi për njohjen e gjuhës angleze;
6. Projekt-propozimi i kërkimit shkencor, i cili përfshin fushën e përzgjedhur të kërkimit shkencor, metodologjinë që do të aplikohet, identifikimin e nevojave për studimin, pritshmëritë e studimit, mundësinë e planit të punës për fonde etj;
7. Lista e artikujve shkencorë (nëse ka);
8. Dy rekomandime nga persona me tituj akademik;
9. Deklarata/ angazhimi i udhëheqësit shkencor;
10. Deklaratë vetjake e kandidatit për studime të vetëfinancuara;
11. Vërtetim i IAL-së se kandidati është angazhuar si personel akademik (nëse ka);
12. Dëshmi për pagesën e tarifës së regjistrimit;
13. Vetëdeklarimi i kandidatit për respektimin e rregullave etike dhe standardeve shkencore;
14. Dëshmi e gjëndjes gjyqësore.

Koha dhe vendi i dorëzimit të dokumentacionit:

Dosja e aplikimit dorëzohet pranë zyrës së koordinatorit të programit të doktoraturës, Dr. Blerina Banushi, në katin e parë të godinës së Universitetit "Barleti", nga e hëna deri të premten, gjatë orarit zyrtar 08:30 – 16:30.